



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, me 17.10.2019

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit Nr. 138 datë 17.10.2019 “Për pranimin e 3 (tre) punonjësve si personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2019 – 2020, ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), që duke filluar nga **data 17.10.2019** deri më **23.10.2019**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

Departamenti i Mjekësisë Sportive, 1 (një) “Lektor” me kohë të pjesshme:

- **Lenda:** “Mësimdhënie”
- Moduli:** “Didaktika e Edukimit Shëndetësor” (Master Profesional)

Departamenti i Mjekësisë Sportive, 2 (dy) “As/Lektor” me kohë të pjesshme:

- **Lenda:** “Mjekësi Sportive”
- Moduli:** “Traumatologji Sportive” (Bacelor)

- **Lenda:** “Biologji dhe Biokimi e Aktivitetit Fizik dhe Sportit”
- Moduli:** “Shëndet Publik” (Bacelor)

Kandidatët e interesuar që konkurojnë për (Lektor) në modulin; “Didaktika e Edukimit Shëndetësor”, duhet të dërgojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND dhe dëshmia e titujve dhe gradave shkencore. (fotokopje e noterizuar)
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të jetë Mjekësisë së Përgjithshme.
- Të jetë i pajisur me licensën e mjekut (fotokopje e noterizuar).
- Të zotërojë një gjuhë të huaj. (fotokopje e noterizuar)
- Preeferohen pedagogë që kanë përvojë në mësimdhënie.
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

Kandidatët e interesuar që konkurojnë për (As/Lektor) në modulin “Traumatologji Sportive” duhet të dërgojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).

- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- Fusha e studimit dhe diplomimitr duhet te jetë Mjekësisë së Përgjithshme.
- Të jetë i pajisur me licensën e mjekut (fotokopje e noterizuar).
- Të zotërojë një gjuhë të huaj. (fotokopje e noterizuar)
- Preeferohen pedagogë që kanë përvojë në mësimdhënie në Traumatologjinë Sportive.
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punes per t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

Kandidatët e interesuar që konkurojnë për (As/Lektor) në modulën : “Shëndet Publik” duhet të dërgojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- Fusha e studimit dhe diplomimitr duhet te jetë shkencat mjekësore.
- Të jetë i pajisur me licensën e mjekut (fotokopje e noterizuar).
- Të zotërojë një gjuhë të huaj. (fotokopje e noterizuar)
- Preeferohen kandidatët që kanë përvojë në institucionet që garantojnë shëndetin e popullatës.
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punes per t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **lenda ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.

Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron CUKA